



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 497/21
Data. 12.10.21



Prishtinë, 12 tetor 2021

Nga: Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së
Për: Z. Serhat Dinç, Drejtor Menaxhues, KESCO Sh.A
Kopje: Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë
Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës
Z. Ferat Shala, Kryesues i Komisionit për zhvillim ekonomik, tregti dhe industri
Znj. Rudina Heroi-Puka, Drejtor për Tarifa dhe Çështje Rregullative, KESCO Sh.A

Lënda: Ri-hapje e procesit për shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe Shpenzimeve Operative për Furnizuesin me Shërbim Universal për periudhën 2022-2024

Po ju drejtohem me qëllim të prezantimit të planeve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) përkitazi me ri-hapjen e procesit për shqyrtimin e vlerave hyrës dhe shpenzimeve operative për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU) për periudhën trevjeçare 2022-2024. Procesi i përcaktimit të vlerave hyrëse, i cili kishte filluar më 10 shtator 2020, nuk ishte përmbyllur për arsye të mungesës së Bordit funksional të ZRRE-së, andaj me kompletimin e Bordit, ZRRE ka vendosur që të vazhdoj këtë proces. Viti 2021 për FSHU është trajtuar me vlerat aktuale hyrëse të vendosur në vitin 2013, pas kompletimit të Bordit është ri-iniciuar procesi i shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative për FSHU që do të vendosen për periudhën tre-vjeçare 2022-2024.

ZRRE me ndryshimet ligjore të vitit 2016, ka zhvilluar legjislacionin sekondar në bazë të të cilit ka krijuar kornizë gjithëpërfshirëse rregullative në shërbim të implementimit të direktivave evropiane dhe ligjeve vendore. Një nga aspektet rregullative esenciale për funksionimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë është siguria e furnizimit për konsumatorët me të drejtë të shërbimit universal. Në këtë kuadër, ZRRE në vitin 2017 ka vendosur Obligim të Shërbimit Publik (OSHP) për furnizim me shërbim universal (FSHU), i cili është vazhduar në vitin 2021 ndaj KESCO.

Duke qenë se ky obligim është vendosur ndaj KESCO-së, është e domosdoshme që kushtet e tregut të rivlerësohen dhe rrjedhimisht edhe kushtet e furnizimit me shërbim universal. Komponentët kyç të cilët duhet të rivlerësohen në kuadër të FSHU, janë vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative të cilat shërbejnë për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave.

Vlerat hyrëse janë parametra të rëndësishëm për përcaktimin e të hyrave të rregulluara për FSHU, ku gjatë këtij procesi do të rishikohen vlerat hyrëse si më poshtë:

- Jetëgjatësia e aseteve;
- Marzha me pakicë;
- Niveli i lejuar i borxhit të keq;
- Faktori ndarës i jobalanceve; si dhe
- Ndonjë parametër tjetër që Rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.



Në mënyrë që të bëhet një vlerësim më i saktë i gjendjes aktuale në lidhje me vlerat hyrëse, FSHU duhet të paraqes të dhënat historike dhe analiza të detajuara në lidhje me borxhin e keq, marzhën me pakicë dhe jobalancet e FSHU (me qëllim të vlerësimit të faktorit ndarës), të cilat do të përcaktohen për periudhën e ardhshme 3 vjeçare.

Duke qenë se gjatë këtij procesi do të përcaktohet edhe OPEX për FSHU, atëherë ZRRE kërkon nga KESCO (FSHU) që të paraqes të gjitha të dhënat ashtu siç kërkohet me Rregullat në fuqi, duke përfshirë kostot aktuale dhe të lejuara, kostot operative dhe të mirëmbajtjes si dhe kostot kapitale, për periudhën 2017-2021 si dhe propozimin për tri vitet në vazhdim (2022-2024). KESCO duhet të paraqes kostot e ndara për konsumatorët në kuadër të FSHU si dhe atyre të derregulluar dhe shërbimet e përbashkëta për të dy llojet e konsumatorëve, duke definuar edhe çelësin e alokimit të këtyre kostove. Gjithashtu, është e domosdoshme të paraqiten kostot për shërbimet e përbashkëta në mes të KESCO dhe KEDS, në të njëjtin parim. Rregullatori do të bëjë azhurnimet e rregullta vjetore për FSHU brenda afateve të përcaktuara me rregullat aktuale të vendosjes së të hyrave.

Orari i ndikativ për procesin e përcaktimit të vlerave hyrëse dhe të shpenzimeve operative për FSHU do të jetë:

- Procesi i shqyrtimit të vlerave hyrëse do të fillojë së paku 120 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant tarifor;
- Përditësimi i të dhënave në formatet e dorëzuara në ZRRE me 8 tetor 2020 dhe propozimeve për vlerat hyrëse dhe shpenzimeve operative nga FSHU do të dërgohet deri më 1 nëntor 2021, apo 20 ditë kalendarike prej ditës së pranimit të kësaj shkrese;
- ZRRE do të shqyrtojë dhe publikojë propozimet preliminare brenda 25 ditëve kalendarike nga pranimi i aplikacioneve nga KESCO.
- Diskutimi publik do të zgjasë 14 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe KESCO dhe të gjitha palët e interesit mund të paraqesin komentet e tyre;
- ZRRE, pas vlerësimit të komenteve do të paraqes propozimin përfundimtar për shqyrtim nga Bordi i ZRRE-së.
- Aplikimi i KESCO për tarifatat me pakicë për konsumatorët fundorë, do të bëhet sipas orarit të përcaktuar në Rregullën e të Hyrave të FSHU-së.

Ky orar është i ndikativ dhe mund të pësojë ndryshime, varësisht prej rrethanave.

Për çdo paqartësi apo informacion shtesë, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,

Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit të ZRRE-së





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



**Ri-hapje e procesit për vlerat hyrëse dhe
OPEX të Furnizuesit me Shërbim Universal**
(Periudha tarifore 2022-2024)

12 tetor 2021



Tabela e përmbajtjes

1	Hyrje	1
2	Qëllimi i shqyrtimit të vlerave hyrëse	2
2.1	Baza ligjore për rregullimin e tarifave.....	2
2.2	Qëllimi i shqyrtimit të vlerave hyrëse	3
3	Afatet kohore	5



1 Hyrje

Ky dokument paraqet ri-hapjen e procesit të shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU). Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) këtë proces e kishte filluar më 10 shtator 2020, i cili përfshinte periudhën tre-vjeçare (2021-2023). ZRRE, më 8 tetor 2020 kishte pranuar nga KESCO “Propozimin për vlerat hyrëse dhe faktorët tjerë që përcaktojnë të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU”, i cili përfshinte periudhën 2021-2023. Prosesi i përcaktimit të vlerave hyrëse nuk është përmbyllur për arsye të mungesës së Bordit funksional të ZRRE-së.

Pas plotësimit të Bordit të ZRRE-së nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, ZRRE ka vendosur që të vazhdojë me procesin e shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU), i cili do të përfshijë periudhën 2022-2024.

Qëllimi i këtij njoftimi është që të:

- ▶ Shpjegojë qëllimin e shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative;
- ▶ Vendosjen e afateve kohore për shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative.

Duke qenë se ky dokument është informues, mundësitë për komente, sqarime lidhur me vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative për palët e interesit do të ofrohen gjatë konsultimit publik.

Çfarëdo komenti i tillë mund të dorëzohet në formë elektronike me e-mail në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org ose të dorëzohet në kopje fizike në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12
Prishtinë, 10000, Kosovë

Dokumentet e ndërlidhura

Ligji për Energjinë Elektrike	http://ero-ks.org/2016/Ligjet/LIGJI_PER_ENERGJINE_ELEKTRIKE.pdf
Ligji për Rregullatorin e Energjisë	http://ero-ks.org/2016/Ligjet/LIGJI_PER_RREGULLATORIN_E_ENERGJISE.pdf
Rregulla për të Hyrat e FSHU	http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Vendosjen%20e%20te%20Hyrave%20per%20Furnizuesin%20me%20Sherbim%20Universal%20(%20Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20FSHU).pdf



2 Qëllimi i shqyrtimit të vlerave hyrëse

Ky seksion përmbledh bazën ligjore dhe qëllimin e shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative. Më shumë detaje rreth fushëveprimit të Shqyrtimit dhe metodologjive të aplikuara mund të gjenden në Rregullën për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU-së), e disponueshme në faqen elektronike të ZRRE-së.

2.1 Baza ligjore për rregullimin e tarifave

Sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka autoritetin dhe përgjegjësitë të miratojë metodologjitë të cilat shfrytëzohen për t'i llogaritur apo për t'i përcaktuar kushtet dhe kriteret:

Neni 15:

1.5. të sigurojë se tarifat e rregulluara për aktivitete të energjisë janë të arsyeshme dhe të vendosura në bazë të një metodologjie tarifore të përshtatshme, të thjeshtë e të lehtë, duke e përfshirë sigurimin e tarifave për sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, adekuate për ta mundur kryerjen e investimeve të domosdoshme në sisteme, në mënyrë që këto investime të garantojnë qëndrueshmëri të sistemeve;

Neni 48:

1. Rregullatori miraton tarifat për shërbimet e rregulluara të energjisë bazuar në metodologjitë e tarifave për tarifat e rregulluara dhe në propozimet për rishikimin e tarifave të dorëzuara nga ndërmarrjet e energjisë. Vendimet e marra për këto propozime publikohen.

Dispozitat ligjore në rastin e furnizimit me energji elektrike në kushte të rregulluara, përkatësisht te furnizimit me shërbim universal janë të parapara edhe në Ligjin për Energjinë Elektrike:

Neni 37

1. Për të siguruar ofrimin e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, Rregullatori mund të ngarkojë me obligime të shërbimit publik cilindo furnizues sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me nenin 5 të këtij Ligji, duke obliguar atë që të ofrojë furnizim me energji elektrike konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal. Këto obligime duhet të vendosen në licencën e të ngarkuarit me obligime të shërbimit publik.

3. Në rast se synimet e shërbimit universal nuk mund të arrihen në kushte të tregut, Rregullatori mund të rregullojë çmimet e energjisë elektrike të blerësve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, me kusht që të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafët 4. deri 8. të këtij neni.

Neni 38:

1.5. për aq kohë sa çmimet e energjisë elektrike të furnizuar nën obligimin e shërbimit publik janë të rregulluara nga Rregullatori, këto çmime duhen miratuar nga Rregullatori në pajtim me metodologjinë e miratuar prej saj., ...

Rregulla e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal:



Neni 6:

Obligimi i shërbimit universal duhet të vendoset mbi furnizuesin e shërbimit publik dhe do të rishikohet të paktën çdo tre (3) vjet ose një periudhë më të shkurtër sipas vlerësimit të Rregullatorit.

Neni 9:

Vlerat hyrëse të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të rregulluara të shërbimit universal të FSHU-së do të caktohen gjatë shqyrtimeve të vlerave hyrëse. Ndryshimet në vlerat hyrëse duhet të bëhen vetëm në atë masë që këto ndryshime të jenë të arsyeshme, të justifikuara dhe të caktuara me kujdes.

2.2 Qëllimi i shqyrtimit të vlerave hyrëse

Gjatë këtij shqyrtimi do të bëhet përcaktimi i vlerave hyrësve të cilat janë komponentë të paracaktuar që aplikohen gjatë përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të Furnizuesit me Shërbim Universal. Vlerat hyrëse që do të përcaktohen do të aplikohen për një periudhë trevjeçare.

Vlerat hyrëse:

Vlerat hyrëse që do të përcaktohen janë:

- Jetëgjatësia e ekonomike e aseteve;
- Marzha me pakicë;
- Niveli i lejuar për borxhet e këqija;
- Faktori ndarës i jobalancit;
- Faktori i efikasitetit të shpenzimeve operative (OPEX);
- Ndonjë parametër tjetër që rregullatori e konsideron të arsyeshëm.

Jetëgjatësia Ekonomike - shpërndarjen sistematike të shumës së zhvlerësueshme të një aseti gjatë jetës së tij të dobishme të lejuar nga baza e aseteve të rregulluara;

Marzha me pakicë - do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e lejuara të energjisë me shumicë dhe kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë.

Borxhi i keq - është komponentë përbërëse e MAR-it. Pas përcaktimit të të nivelit të borxhit të keq, MAR-i përfundimtar kalkulohet duke pjesëtuar vlerën fillestare të MAR-it për (1-borxhi i keq%).

Faktori ndarës i jobalancit - duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot neto të jobalancit për të përcaktuar ndarjen e këtyre shpenzimeve në mes të FSHU-së dhe konsumatorëve të rregulluar, ku vlera prej 0% nënkupton që të gjitha kostot neto të jobalancit i alokohen FSHU-së, ndërsa vlera prej 100% nënkupton që të gjitha kostot neto të jobalancit u alokohen konsumatorëve. Çdo vlerë në mes të 0 dhe 100, paraqet ndarjen e këtyre kostove në mes të konsumatorëve dhe FSHU.

Faktori i efikasitetit – paraqet një cak për reduktimin e shpenzimeve operative, i përcaktuar nga Rregullatori për periudhë rregullative.



Përcaktimi i vlerave hyrëse të arsyeshme

Si pjesë e këtij procesi, ZRRE do të shqyrtojë vlerat hyrëse në mënyrë të detajuar, për t'u siguruar se nga aplikimi i tyre rezultojnë kosto të arsyeshme dhe ofrohen stimuj të përshtatshëm për përmirësimin e efikasitetit në kostot e sistemit. Ky shqyrtim do të fillojë me mbledhjen e të dhënave relevante nga furnizuesi me shërbim universal, si dhe të dhëna nga të licencuarit e tjerë që ndërlidhen me kostot nga aplikimi i vlerave hyrëse të FSHU. Analiza e ZRRE-së e këtyre të dhënave dhe konkluzionet e tij mbi nivelin e Vlerave Hyrëse dhe Shpenzimeve Operative do të bëhen publike dhe do të konsultohen me të gjitha palët e interesit, para vendimmarrjes.

Duhet theksuar se një nga vlerat hyrëse të sipërpërmendura që ka të bëjë me efikasitetin e shpenzimeve operative është përcaktimi i faktorit të efikasitetit. Për të përcaktuar atë është e domosdoshme përcaktimi i nivelit të duhur të OPEX-it të FSHU-së. Andaj, në kuadër të këtij shqyrtimi përveç përcaktimit të Vlerave Hyrëse duhet përcaktuar edhe niveli i OPEX-it për periudhën prej tri viteve duke e azhurnuar atë për faktorët që janë jashtë kontrollit të tij, siç mund të jenë (inflacioni, kostot që ndërlidhen me daljen e konsumatorëve në treg, apo ndonjë obligim të ndryshëm ligjor).

Gjatë shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe OPEX-it, ZRRE-ja mund të marrë parasysh:

- Vlerat hyrëse historike të lejuara dhe aktuale;
- Kostot historike të lejuara dhe aktuale;
- Projektionet e kostove të ardhshme që rezultojnë nga vlerat hyrëse të ardhshme;
- Krahasimet e ndërmarrjeve të ngjashme, si në Kosovë ashtu edhe në vende të tjera në Evropë.



3 Afatet kohore

Afati kohor i propozuar për shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe të OPEX-it tregohet në tabelën e mëposhtme. Ky afat kohor mund të rishikohet ndërsa zhvillohet ky proces.

Shqyrtimi i Vlerave Hyrëse dhe i OPEX-it fillon me publikimin e këtij dokumenti iniciues.

Orari indikativ për përcaktimin e vlerave hyrëse dhe OPEX-it është i paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Orari indikativ

Nr.	Veprimi	Përgjegjësia	Data
1	Inicimi (ri-fillim) i procesit të vlerave hyrëse	ZRRE	12 tetor 2021
2	FSHU përditëson Formularët e plotësuar për vlerat hyrëse dhe OPEX, duke përfshirë të dhënat aktuale dhe parashikimin 2022-2024	FSHU	1 nëntor 2021
3	ZRRE publikon propozimet fillestare të saj për vlerat hyrëse dhe për OPEX	ZRRE	25 nëntor 2021
4	Konsultimi publik (paraqitja e komenteve)	FSHU dhe palët e interesit	8 dhjetor 2021
5	Raporti final për vlerat hyrëse dhe për OPEX të FSHU-së	ZRRE	30 dhjetor 2021